



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2021 – Numri: 106

Tiranë – E premte, 2 korrik 2021

PËRMBAJTJA

	Faqe
Dekret i Presidentit nr. 13120, datë 29.6.2021	Për lejimin e lënies së shtetësisë shqiptare..... 9867
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 27, datë 1.7.2021	Për një shtesë në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 9867
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 381, datë 30.6.2021	Për lirim nga detyra..... 9867
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 382, datë 30.6.2021	Për lirim nga detyra..... 9868
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 383, datë 30.6.2021	Për emërim në detyrë..... 9868
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 395, datë 30.6.2021	Për përcaktimin e metodologjisë së llogaritjes dhe kufijve të kuotës BID..... 9868
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 396, datë 30.6.2021	Për miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së grantit për asistencë teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e përgatitjes së një studimi fizibiliteti për projektet e infrastrukturës së transportit në zonat bregdetare jugore të Shqipërisë..... 9874
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 404, datë 30.6.2021	Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rikonstruksionit të rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari - Gjelbërimi”, të ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës..... 9877
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 405, datë 30.6.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar”, të ndryshuar..... 9877

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 406, datë 30.6.2021	Për disa ndryshime në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përdorimin e fondit të rindërtimit, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave”, të ndryshuar.....	9878
Urdhër i përbashkët i ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe i ministrit të Turizmit dhe Mjedisit nr. 295, datë 18.6.2021	Për miratimin e “Protokollit të masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik”	9879
Urdhër i ministrit të Brendshëm nr. 238, datë 27.5.2021	Për delegimin e kompetencave.....	9886

**DEKRET****Nr. 13120, datë 29.6.2021****PËR LEJIMIN E LËNIES SË
SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe të neneve 13, 14 e 20 dhe në vijim, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, me propozimin e Ministrisë së Brendshme,

DEKRETOJ:**Neni 1**

U lejohej lënia e shtetësisë shqiptare, me kërkesë të tyre, personave të mëposhtëm:

1. Griselda Medi Amende (Allamani)
2. Klevis Fatos Ibrahim
3. Marinela Astrit Cenolli
4. Aleksandër (Alexander) Kristian (Cristian) George-Eduard Dina
5. Dolora Spiro Hallullaj
6. Mirgena Bajram Cërriku (Tolja)
7. Klesta Agron Hoxha
8. Mikel Ledion Danaj
9. Elton Qerim Çapani
10. Algert Gëzim Korita
11. Esi Përparim Ramaj
12. Vasil Theodhori Biri
13. Elida Zenelabedin Brahja (Shpati)

**PRESIDENT I REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË**
Ilir Meta

AKT NORMATIV
Nr. 27, datë 1.7.2021**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.9920,
DATË 19.5.2008, “PËR PROCEDURAT
TATIMORE NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Në kreun XV, pas pikës 6, të nenit “Dispozita kalimtare”, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore”, të ndryshuar, shtohet pika 7, me këtë përmbajtje:

“7. Përjashtimisht parashikimeve në këtë ligj, për kundërvajtjet administrative që lidhen me afatet e hyrjes në fuqi dhe zbatimin efektiv të ligjit nr. 87/2019, “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, të ndryshuar, zbatimi i sanksioneve do të fillojë të aplikohet pas datës 1 janar 2022.”.

Neni 2

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

VENDIM
Nr. 381, datë 30.6.2021**PËR LIRIM NGA DETYRA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Etjen Xhafaj, zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



VENDIM

Nr. 382, datë 30.6.2021

PËR LIRIM NGA DETYRA

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Z. Petro Koçi, zëvendësministër i Mbrojtjes lirohet nga kjo detyrë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 383, datë 30.6.2021

PËR EMËRIM NË DETYRË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 6, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Znj. Megi Fino emërohet zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR

Erion Braçe

VENDIM

Nr. 395, datë 30.6.2021

PËR PËRCAKTIMIN E
METODOLOGJISË SË LLOGARITJES
DHE KUFIJVE TË KUOTËS BID

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 63/2020, “Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)”, me propozimin të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e metodologjisë së llogaritjes dhe kufijve të kuotës BID, në kuptim të pikës 2, të nenit 15, të ligjit nr. 63/2020, “Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)”.

2. Përveç përkufizimeve të parashikuara në nenin 2, të ligjit nr. 63/2020, “Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)”, termat në vijim kanë këto kuptime:

a) “**Objekt i veprimtarisë së pagesve të kuotës BID**”, objekti i veprimtarisë që ushtron poseduesi në njësinë tregtare të zonës BID, siç përcaktohet në ekstraktin e subjektit të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ose, për organizatat jofitimprurëse, siç përcaktohet në ekstraktin e lëshuar nga regjistri i organizatave jofitimprurëse pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë;

b) “**Qarkullim vjetor i pagesve të kuotës BID**”, të ardhurat e faturuara totale vjetore të çdo pagesi të kuotës BID për vitin e mëparshëm fiskal, pavarësisht nëse janë subjekte tregtare ose organizata jofitimprurëse;

c) “**Sipërfaqe e njësisë tregtare**”, madhësia në metër katror e sipërfaqes së pasurisë së paluajtshme, ku ushtron aktivitetin pagesi i kuotës BID;

ç) “**Vlera e njësisë tregtare**”, vlera e llogaritur bazuar në çmimin mesatar referues të shitblerjes për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtime dhe ambiente jobanimit të përcaktuar në aktin nënligjor për metodologjinë e përcaktimit të vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme “ndërtesa”, i cili është në fuqi në datën e propozimit për BID. Për efekt të



llogaritjes së kuotës BID, si vlerë e njësisë tregtare merret vlera që rezulton nga shumëzimi i çmimit mesatar referues të shitblerjes për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtime dhe ambiente jobanimit me sipërfaqen e njësisë tregtare përkatëse që ndodhet në zonën e propozuar BID.

3. Deklarimi dhe mënyra e llogaritjes së kuotës BID nga propozuesi i BID-it realizohet në përputhje me parashikimin e pikës 1, të nenit 15, të ligjit nr. 63/2020, “Për përmirësimin e zonave të biznesit (BID)”. Për përcaktimin e vlerës së kuotës BID, propozuesi i BID-it bazohet në planin e biznesit të hartuar për krijimin dhe funksionimin e BID-it.

4. Llogaritja e kuotës BID bazohet në një ose disa kriteret objektive të përzgjedhura nga propozuesi i BID-it ndërmjet kriterëve objektive bazë dhe kriterëve objektive plotësuese, si më poshtë vijon:

a) kriteret objektive bazë:

i. qarkullimi vjetor i pagesve të kuotës BID;

ii. vlera e njësisë tregtare;

b) kriteret objektive plotësuese:

i. objekti i veprimtarisë së pagesit të kuotës BID;

ii. vendndodhja e njësisë tregtare në zonën BID;

iii. përdorimi i hapësirës publike në zonën BID nga pagesit e kuotës BID.

5. Kriteret objektive plotësuese përdoren të kombinuara me të paktën njërin prej kriterëve objektive bazë të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 4, të këtij vendimi. Në rast se përdoren dy ose më shumë kriteret objektive, propozuesi i BID-it përcakton në propozimin dhe prospektin BID peshën në përqindje të secilit kriter objektiv, ku pesha në përqindje e kriterëve objektive bazë duhet të jetë të paktën 60 (gjashtëdhjetë) % e buxhetit vjetor që mbulohet nga kuotat BID në bazë të planit të biznesit. Mbi bazën e peshës në përqindje mbi buxhetin vjetor që mbulohet nga kuotat BID, propozuesi i BID-it llogarit buxhetin vjetor të BID-it për çdo kriter objektiv të përzgjedhur.

6. Kuota BID për çdo pages të saj përbën shumën e vlerave absolute të llogaritura për secilin kriter objektiv të përzgjedhur. Vlera absolute vjetore e kuotës BID për çdo pages të kuotës BID, në çdo rast, nuk mund të jetë më

shumë se 2 (dy) % e vlerës së njësisë tregtare përkatëse.

7. Kur përdoret kriteri objektiv bazë “qarkullimi vjetor i pagesve të kuotës BID”, propozuesi i BID-it përcakton në propozimin për BID-in dhe prospektin BID, koeficientin në përqindje, i cili, i shumëzuar me qarkullimin vjetor përkatës të çdo pagesi të kuotës BID, rezulton në vlerën e kuotës BID për çdo pages të saj. Ky koeficient llogaritet si raport i pjesës së buxhetit vjetor të BID-it, që do të mbulohet nga kuotat BID, sipas planit të biznesit, me vlerën totale të qarkullimit vjetor të të gjithë pagesve të kuotës BID në zonën e propozuar BID. Informacioni për qarkullimin vjetor të merret nga drejtoria rajonale tatimore përkatëse ose nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) për çdo pages të kuotës BID.

8. Kur përdoret kriteri objektiv bazë “vlera e njësisë tregtare”, propozuesi i BID-it përcakton në propozimin për BID-in dhe në prospektin BID koeficientin në përqindje, i cili, i shumëzuar me vlerën e njësisë tregtare përkatëse të çdo pagesi të kuotës BID, rezulton në vlerën e kuotës BID për çdo pages të saj. Ky koeficient llogaritet si raport i pjesës së buxhetit vjetor të BID-it, që do të mbulohet nga kuotat BID, sipas planit të biznesit, me vlerën totale të të gjitha njësive tregtare në zonën e propozuar BID. Informacioni për sipërfaqen e çdo njësie tregtare, merret nga zyra vendore e taksave dhe tatimeve e bashkisë përkatëse ose nga kartela e përditësuar e pronës, lëshuar nga zyra vendore përkatëse e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës.

9. Në rast se gjatë kohëzgjatjes së BID-it të miratuar ndryshon çmimi mesatar referues i shitblerjes për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtime dhe ambiente jobanimit, kuota BID nuk ndryshon deri në përfundim të kohëzgjatjes së BID-it. Në rast se BID-i përkatës rinovohet, kuota BID llogaritet mbi bazën e çmimit mesatar referues të shitblerjes për metër katror, sipërfaqe ndërtimi për ndërtime dhe ambiente jobanimit, të përcaktuar në aktin nënligjor përkatës në fuqi në datën e propozimit të rinovimit të BID-it.

10. Kur përdoret si kriter objektiv plotësues “objekti i veprimtarisë”, propozuesi i BID-it llogarit vlerën absolute të këtij kriteri objektiv plotësues për kategori pagesish të kuotës BID, sipas objektit të veprimtarisë së tyre, e cila, duke



u pjesëtuar me numrin e paguesve të kuotës BID në secilën kategori, rezulton në vlerën absolute të këtij kriteri objektiv plotësues për çdo pagues të kuotës BID. Për të llogaritur vlerën absolute të këtij kriteri objektiv plotësues për kategori, propozuesi i BID-it përcakton peshën në përqindje të secilës kategori paguesish të kuotës BID, e cila rezulton nga raporti i totalit të qarkullimit vjetor të paguesve të kuotës BID për kategori me totalin e qarkullimit vjetor të të gjithë paguesve të kuotës BID, shumëzuar me pjesën e buxhetit vjetor të BID-it për këtë kriter objektiv plotësues. Informacioni për qarkullimin vjetor merret në përputhje me parashikimin e dhënë në pikën 7, të këtij vendimi, ndërsa informacioni për objektin e veprimtarisë së paguesit të kuotës BID merret nga Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ose nga regjistri i OJF-ve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

11. Kur përdoret si kriter objektiv plotësues “vendndodhja e njësisë tregtare në zonën BID”, propozuesi i BID-it llogarit vlerën absolute të këtij kriteri objektiv plotësues për çdo pagues të kuotës BID, sipas vendndodhjes dhe sipërfaqes

$$k = \frac{\text{pjesa e buxhetit vjetor të BID-it për kriterin objektiv "vendndodhje"}}{\sum ((s1 \times 50\%) + (s2 \times 30\%) + \dots + (sn \times \% \text{ sipas kategorisë së vendndodhjes}))}$$

12. Kur përdoret si kriter objektiv plotësues “përdorimi i hapësirës publike nga njësitë tregtare”, propozuesi i BID-it llogarit vlerën absolute të këtij kriteri objektiv plotësues për çdo pagues të kuotës BID, sipas hapësirës publike të marrë në përdorim prej tyre në zonën BID. Propozuesi i BID-it llogarit koeficientin në përqindje, i cili i shumëzuar me tarifën e pagueshme në bashki për kohëzgjatjen e përdorimit të hapësirës publike nga çdo pagues i kuotës BID, rezulton në vlerën absolute të kriterit objektiv plotësues për çdo pagues të kuotës BID. Koeficienti llogaritet si raport i pjesës së buxhetit vjetor të BID-it për këtë kriter objektiv plotësues me vlerën totale të tarifave të pagueshme në bashki nga të gjithë paguesit e kuotës BID, përdorues të hapësirës publike, pjesë e zonës së propozuar BID. Tarifa e përdorimit të hapësirës publike për çdo pagues të kuotës BID rezulton nga shumëzimi i sipërfaqes në metër katror të hapësirës publike të marrë në

së njësisë tregtare përkatëse, duke marrë në konsideratë faktorët që ndikojnë në përparësitë konkurruese për çdo pagues të kuotës BID, të tilla, si: aksesit i vizitorëve në zonën BID, vizibiliteti dhe largësia nga sheshi kryesor. Propozuesi i BID-it llogarit koeficientin (k), i cili i shumëzuar me sipërfaqen e secilës njësi tregtare që ndodhet në zonën BID ($s_1, s_2 \dots s_n$) dhe peshën në përqindje të kategorisë përkatëse të vendndodhjes së saj (p.sh. 50%, 30% ...), rezulton në vlerën absolute të këtij kriteri objektiv plotësues për çdo pagues të kuotës BID. Peshë në përqindje përcaktohet nga propozuesi i BID-it për çdo kategori paguesish të kuotës BID, sipas vendndodhjes së tyre. Koeficienti (k) llogaritet si raport i pjesës së buxhetit vjetor të BID-it për këtë kriter objektiv plotësues me totalin e sipërfaqeve përkatëse të secilës njësi tregtare të shumëzuara përkatësisht me peshën në përqindje, sipas kategorisë së vendndodhjes së njësisë tregtare, sipas formulës më poshtë. Informacioni për sipërfaqen e çdo njësie tregtare merret në përputhje me parashikimin e dhënë në pikën 8, të këtij vendimi:

përdorim me numrin e muajve që përdoret kjo hapësirë dhe vlerën e tarifës mujore, e cila përcaktohet në paketën fiskale të bashkisë përkatëse. Me kërkesë të propozuesit të BID-it, zyra vendore e taksave dhe e tatimeve e njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse i jep propozuesit të BID-it informacionin për sipërfaqet publike të marra apo që do të merren në përdorim nga paguesit e kuotës BID në zonën BID, së bashku me informacionin për kohëzgjatjen në muaj të përdorimit të hapësirës publike, si dhe vlerën e tarifës për përdorimin e hapësirës publike për zonën e propozuar BID, sipas përcaktimeve në vendimin në fuqi të këshillit bashkiak përkatës për miratimin e taksave dhe të tarifave vendore vjetore të zbatueshme në juridiksionin e njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse.

13. Në përcaktimin e peshës përkatëse në përqindje të kriterit objektiv plotësues “përdorim i hapësirës publike nga njësitë tregtare” për



llogaritjen e kuotës BID, propozuesi i BID-it merr në konsideratë faktorët që mund të ndikojnë në luhatjen e vlerës së kuotës BID, bazuar në këtë kriter objektiv plotësues, të tilla, si: përdorimi i hapësirës publike për periudha kohore më të shkurtra se një vit kalendarik, ndryshimi i vlerës së paguar të tarifës për përdorimin e hapësirës publike gjatë kohëzgjatjes së BID-it të propozuar, si dhe ndryshimi periodik i bizneseve përdoruese të hapësirës publike.

14. Llogaritja e kuotës BID bëhet në përputhje me përmbajtjen e këtij vendimi dhe shembujt e dhënë në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur.

15. Ngarkohen njësitë e vetëqeverisjes vendore, zyrat vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, si dhe drejtoritë rajonale tatimore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCË NR. 1

Shembull nr. 1. Llogaritja e kuotës BID bazuar në kriterin objektiv bazë “Qarkullimi vjetor i paguesve të kuotës BID”

Supozojmë se në planin e biznesit, propozuesi i BID-it ka parashikuar që, për kryerjen e shërbimeve të BID-it, që do të mbulohen nga kuota BID, do të shpenzohen 3,000,000 lekë/vit dhe se në zonën BID ndodhen 100 njësi tregtare/pagues të kuotës BID me total të qarkullimit vjetor prej 247,000,000 lekësh.

Raporti ndërmjet buxhetit vjetor të parashikuar në planin e biznesit përkatës (3,000,000 lekë) me qarkullimin vjetor total të paguesve të kuotës BID në zonën e propozuar përcakton koeficientin 1.215% ($3,000,000 \text{ lekë} / 247,000,000 \text{ lekë} \times 100$) me të cilin llogaritet vlera e kuotës BID. Ky koeficient, duke u shumëzuar me qarkullimin vjetor të secilit pagues të kuotës BID në zonën BID, jep vlerën e kuotës BID për secilin pagues të kuotës BID. Për paguesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 500,000 lekë, kuota BID rezulton 6,075 lekë/vit ($1.215\% \times 500,000 \text{ lekë}$), ndërsa për paguesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 14,000,000 lekë,

kuota BID rezulton 170,100 lekë/vit ($1.215\% \times 14,000,000 \text{ lekë}$).

Shembull nr. 2. Llogaritja e kuotës BID bazuar në kriterin objektiv bazë “Vlera e njësisë tregtare”

Supozojmë se në të njëjtën zonë BID, si në shembullin 1 më sipër, kriteri objektiv bazë që merret parasysh për llogaritjen e kuotës BID është vlera e njësisë tregtare. Si në shembullin nr. 1, propozuesi i BID-it ka parashikuar në planin e biznesit që për kryerjen e shërbimeve të BID-it, që do të mbulohen nga kuota BID, do të shpenzohen 3,000,000 lekë/vit dhe në zonën BID ndodhen 100 njësi tregtare. Totali i sipërfaqes së njësive tregtare në zonën BID është 16,070 m².

Çmimi mesatar referues i shitblerjes për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtime dhe mjedise jo banimi në zonën BID të propozuar është 58,922 lekë/m². Totali i vlerës së njësive tregtare sipas çmimit mesatar referues të shitblerjes për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtime dhe mjedise jo banimi në zonën BID të propozuar është 947,000,000 lekë.

Raporti ndërmjet buxhetit vjetor të parashikuar në planin e biznesit përkatës (3,000,000 lekë) me vlerën totale të njësive tregtare në zonën e propozuar BID përcakton koeficientin 0.317% ($3,000,000 \text{ lekë} / 947,000,000 \text{ lekë} \times 100$), me të cilin llogaritet vlera e kuotës BID. Ky koeficient, duke u shumëzuar me vlerën e secilës njësi tregtare, jep vlerën e kuotës BID për secilin pagues të kuotës BID. Sipas vlerës së njësive tregtare që posedojnë, paguesit e kuotës BID do të paguajnë nga 2,802 lekë/vit për njësinë tregtare me sipërfaqe 15 m² ($0.317\% \times 15 \text{ m}^2 \times 58,922 \text{ lekë}$) deri në 280,174 lekë/vit për njësinë tregtare me sipërfaqe 1,500 m² ($0.317\% \times 1,500 \text{ m}^2 \times 58,922 \text{ lekë}$).

Shembull nr. 3. Llogaritja e kuotës BID bazuar në dy kriteret objektive (një kriter objektiv bazë dhe një kriter objektiv plotësues):

Kriteri 1 – qarkullimi vjetor i paguesve të kuotës BID;

Kriteri 2 – objekti i veprimtarisë së paguesve të kuotës BID.

Supozojmë se në të njëjtën zonë BID, si në shembujt e mësipërm, kuota BID propozohet të llogaritet në bazë të dy kriterëve objektive,



përkatësisht kriterit objektiv bazë “qarkullimi vjetor” dhe kriterit objektiv plotësues “objekti i veprimtarisë”. Si në shembujt e mësipërm, propozuesi i BID-it ka parashikuar në planin e biznesit që për kryerjen e shërbimeve të BID-it, që do të mbulohen nga kuota BID, do të shpenzohen 3,000,000 lekë/vit dhe në zonën BID ndodhen 100 njësi tregtare, sipas kategorive të mëposhtme:

- artizanë 48, qarkullimi vjetor i të cilëve është 20 (njëzet) % e qarkullimit total të të gjithë paguesve të kuotës BID;
- shitës të ndryshëm 14, me 13 (trembëdhjetë) % të qarkullimit total;
- shërbime 10, me 21 (njëzet e një) % të qarkullimit total;
- bar-kafe restorante 21, me 25 (njëzet e pesë) % të qarkullimit total;
- njësi akomoduese 7, me 21 (njëzet e një) % të qarkullimit total.

Totali i qarkullimit vjetor të paguesve të kuotës BID është 247,000,000 lekë.

Propozuesi i BID-it përcakton peshën në përqindje për secilin kriter objektiv, si më poshtë vijon:

- qarkullimi vjetor 60%;
- objekti i veprimtarisë 40%.

Pjesa e buxhetit vjetor për kriterin objektiv bazë është 1,800,000 lekë ($60\% \times 3,000,000$ lekë) dhe pjesa e buxhetit vjetor për kriterin objektiv plotësues është 1,200,000 lekë ($40\% \times 3,000,000$ lekë).

Vlera absolute e kriterit objektiv bazë llogaritet si në shembullin nr. 1. Koeficienti 0.73% ($1,800,000 \text{ lekë} / 247,000,000 \text{ lekë} \times 100$) shumëzohet me qarkullimin vjetor të secilit pagues të kuotës BID, për të llogaritur vlerën absolute të kriterit objektiv bazë. Për paguesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 500,000 lekë, vlera e kriterit objektiv bazë rezulton 3,650 lekë ($0.73\% \times 500,000 \text{ lekë}$), ndërsa për paguesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 14,000,000 lekë, vlera e kriterit objektiv bazë rezulton 102,200 lekë ($0.73\% \times 14,000,000 \text{ lekë}$).

Pjesa e buxhetit vjetor për kriterin objektiv plotësues (1,200,000 lekë) shumëzohet me përqindjen që zë secila kategori në vlerën totale të qarkullimit vjetor të të gjithë paguesve të kuotës BID dhe rezulton në totalin e vlerës së kriterit objektiv plotësues për secilën kategori

veprimtarie. Vlera e kriterit objektiv plotësues për kategorinë e artizanëve është 240,000 lekë ($20\% \times 1,200,000 \text{ lekë}$), ndërsa për kategorinë e njësive akomoduese është 252,000 lekë ($21\% \times 1,200,000 \text{ lekë}$). Kjo vlerë totale pjesëtohet me numrin e njësive tregtare përkatëse dhe jep si rezultat vlerën absolute të kriterit objektiv plotësues për çdo pagues të kuotës BID. Kuota BID për çdo pagues të saj përbëhet nga shuma e vlerave absolute të kriterit objektiv bazë dhe kriterit objektiv plotësues për çdo pagues të kuotës BID.

Për kategorinë “Artizanë”, vlera absolute e kriterit objektiv plotësues rezulton 5,000 lekë/vit ($20\% \times 1,200,000 \text{ lekë} / 48 \text{ artizanë}$) ndërsa për kategorinë “Njësi akomoduese”, vlera absolute e kriterit objektiv plotësues rezulton 36,000 lekë/vit ($21\% \times 1,200,000 \text{ lekë} / 7 \text{ njësi akomoduese}$).

Kuota BID për artizanin me qarkullim vjetor 500,000 lekë është 8,650 lekë (3,650 lekë + 5,000 lekë) dhe kuota BID për njësinë akomoduese me qarkullim vjetor 14,000,000 lekë është 138,200 lekë (36,000 lekë + 102,200 lekë).

Shembull nr. 4. Llogaritja e kuotës BID bazuar në katër kriterë objektive (dy kriterë objektive bazë dhe dy kriterë objektive plotësuese):

Kriteri 1 – qarkullimi vjetor i paguesve të kuotës BID;

Kriteri 2 – vlera e njësive tregtare;

Kriteri 3 – përdorimi i hapësirës publike;

Kriteri 4 – vendndodhja e njësive tregtare në zonën BID.

Supozojmë se në të njëjtën zonë BID, me të njëjtën përbërje të njësive tregtare si në shembujt e mësipërm, vlera e kuotës BID propozohet të llogaritet në bazë të katër kriterëve objektive. Si në shembujt e mësipërm, propozuesi i BID-it ka parashikuar në planin e biznesit, që për kryerjen e shërbimeve të BID-it, që do të mbulohen nga kuota BID, do të shpenzohen 3,000,000 lekë/vit dhe në zonën BID ndodhen 100 njësi tregtare. Totali i qarkullimit vjetor të paguesve të kuotës BID është 247,000,000 lekë.

Totali i sipërfaqes së njësive tregtare në zonën BID është 16,070 m², me çmim mesatar referues të shitblerjes për metër katror sipërfaqe ndërtimi për ndërtime dhe ambiente jo banimi në zonën e propozuar BID prej 58,922 lekë/m² dhe totali i



vlerës së njësive tregtare sipas këtij «mimi është 947,000,000 lekë.

Paguesit e kuotës BID, që kanë në përdorim hapësirën publike me sipërfaqe totale prej 545 m² në zonën BID, për një periudhë përdorimi 6-mujore për secilin prej tyre, me tarifë mujore prej 350 lekë/m², paguajnë së bashku vlerën totale prej 1,144,500 lekësh.

Lidhur me kriterin e vendndodhjes së njësive tregtare në zonën BID, propozuesi i BID përcakton peshën në përqindje për secilën kategori të vendndodhjes, si vijon: kategoria A 50%, kategoria B 30%, kategoria C 15% dhe kategoria D me 5%, ku kategoria A është vendndodhja më e favorshme dhe kategoria D është vendndodhja më pak e favorshme. Supozojmë se:

- në kategorinë A të vendndodhjes gjenden njësitë tregtare me sipërfaqe totale 4,820 m²;
- në kategorinë B të vendndodhjes gjenden njësitë tregtare me sipërfaqe totale 6,430 m²;
- në kategorinë C të vendndodhjes gjenden njësitë tregtare me sipërfaqe totale 3,215 m²;
- në kategorinë D të vendndodhjes gjenden njësitë tregtare me sipërfaqe totale 1,605 m².

Propozuesi i BID-it propozon peshën në përqindje për secilin kriter objektiv, si më poshtë:

- qarkullimi vjetor 60%;
- vlera e njësive tregtare 20%;
- përdorimi i hapësirës publike 15%;
- vendndodhja e njësive tregtare 5%.

Pjesa e buxhetit vjetor për kriterin objektiv bazë “qarkullimi vjetor” është 1,800,000 lekë (60% x 3,000,000 lekë); për kriterin objektiv bazë “vlera e njësive tregtare” është 600,000 lekë (20% x 3,000,000 lekë); për kriterin objektiv plotësues “përdorim i hapësirës publike” është 450,000 lekë (15% x 3,000,000 lekë) dhe për kriterin objektiv plotësues “vendndodhja e njësive tregtare” është 150,000 lekë (5% x 3,000,000 lekë).

Vlera absolute e kriterit objektiv bazë “qarkullimi vjetor” është sa në shembullin nr. 3, pra, për pagesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 500,000 lekë, është 3,650 lekë (0.73% x 500,000 lekë), ndërsa për pagesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 14,000,000 lekë, është 102,200 lekë (0.73% x 14,000,000 lekë).

Vlera absolute e kriterit objektiv bazë “vlera e njësive tregtare” llogaritet si në shembullin nr. 2.

Koeficienti 0.063% (600,000 lekë/947,000,000 lekë) shumëzohet me vlerën e njësive tregtare të secilit pages të kuotës BID për të llogaritur vlerën absolute të këtij kriteri objektiv bazë. Për pagesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 500,000 lekë dhe me sipërfaqe njësie tregtare 15 m², vlera e këtij kriteri objektiv bazë rezulton 557 lekë (0.063% x 15m² x 58,922 lekë/m²), ndërsa për pagesin e kuotës BID, me qarkullim 14,000,000 lekë dhe me sipërfaqe njësie tregtare 1,500 m², vlera e këtij kriteri objektiv bazë rezulton 55,681 lekë (0.063% x 1,500m² x 58,922 lekë/m²).

Vlera absolute e kriterit objektiv plotësues “përdorim i hapësirës publike” llogaritet duke shumëzuar koeficientin 39.32% (450,000 lekë/1,144,500 lekë) me tarifat e pagueshme në bashki nga çdo përdorues i hapësirës publike në zonën BID. Për pagesit e kuotës BID, që nuk përdorin hapësirë publike, vlera e këtij kriteri objektiv plotësues rezulton 0 lekë/vit (39,32% x 0 lekë). Për pagesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 14,000,000 lekë, sipërfaqe njësie tregtare 1,500 m², që përdor hapësirë publike prej 50 m² për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muajsh, vlera e këtij kriteri objektiv plotësues rezulton në 41,286 lekë (39,32% x 50 m² x 350 lekë/muaj x 6 muaj).

Vlera absolute e kriterit objektiv plotësues “vendndodhja e njësive tregtare” llogaritet duke shumëzuar koeficientin 30.6 (150,000 lekë/(4,820 m² x 50% + 6,430 m² x 30% + 3,215 m² x 15% + 1,605 m² x 5%)) me sipërfaqen e secilës njësi tregtare dhe peshën në përqindje të kategorisë përkatëse të vendndodhjes. Për pagesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 500,000 lekë dhe me sipërfaqe njësie tregtare 15 m², i cili nuk përdor hapësirë publike dhe është në kategorinë A sipas vendndodhjes, vlera e këtij kriteri objektiv plotësues rezulton 230 lekë (30.6 x 15 m² x 50%), ndërsa për pagesin e kuotës BID me qarkullim 14,000,000 lekë dhe me sipërfaqe njësie tregtare 1,500 m², i cili përdor hapësirë publike prej 50 m² për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muajsh, dhe është në kategorinë C sipas vendndodhjes, vlera e këtij kriteri objektiv plotësues rezulton 6,885 lekë (30.6 x 1,500 m² x 15%).

Për pagesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 500,000 lekë dhe me sipërfaqe njësie



tregtare 15 m², i cili nuk përdor hapësirë publike dhe është në kategorinë A sipas vendndodhjes, kuota BID është 4,437 lekë (3,650 lekë + 557 lekë + 0 lekë + 230 lekë).

Për paguesin e kuotës BID me qarkullim vjetor 14,000,000 lekë dhe me sipërfaqe njësie tregtare 1,500 m², i cili përdor hapësirë publike prej 50 m² për një periudhë kohe prej 6 (gjashtë) muajsh dhe është në kategorinë C, sipas vendndodhjes, kuota BID është 206,052 lekë (102,200 lekë + 55,681 lekë + 41,286 lekë + 6,885 lekë).

VENDIM

Nr. 396, datë 30.6.2021

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES
NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
LETRASH TË MARRËVESHJES SË
GRANTIT PËR ASISTENCË TEKNIKE
NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË DHE FONDIT TË
KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN
EKONOMIK ARAB, PËR FINANCIMIN E
PËRGATITJES SË NJË STUDIMI
FIZIBILITETI PËR PROJEKTET E
INFRASTRUKTURËS SË TRANSPORTIT
NË ZONAT BREGDETARE JUGORE
TË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 12 e 23, të ligjit nr. 43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes ndryshuese me shkëmbim letrash të marrëveshjes së grantit për asistencë teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për financimin e përgatitjes së një studimi fizibiliteti për projektet e infrastrukturës së transportit në zonat bregdetare jugore të Shqipërisë, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe



FONDI I KUVAJTIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB

Ref: KF/ 11G6 - 59		Faqet totale: 1
Data: 11/4/2021	Administrimi & Operacionet	CF: AB/45/11
Faks: (965) 22999190 (965) 22999091	Telefon (965) 22999000 E-mail: operations@kuwait-fund.org	Faqja e internetit: http://www.kuwait-fund.org

Drejtuar:**Nr. Faksi/ E-mail**

SH.S.Znj. Anila Denaj
Ministre e Financave dhe Ekonomisë
Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Tiranë- Republika e Shqipërisë

+355 422 28494
info@financa.gov.al

Për dijeni:

1. Z. Dritan Agolli
Fondi Shqiptar i Zhvillimit
Tiranë - Republika e Shqipërisë
+355 422 34885
adf@albaniaandf.org
2. Ambasada e Shtetit të Kuvajtit
Tiranë, Republika e Shqipërisë
+355 422 36501
kw.tirana@mofaq.gov.ke
kuwaitembassy.tirana@gmail.com
3. Ambasada e Republikës së Shqipërisë
Shteti i Kuvajtit
25240628

Lënda: Ndihmë Teknike për Financimin e Përgatitjes së një Studimi Fizibiliteti për Projektet e Infrastrukturës së Transportit në Zonat Bregdetare Jugore të Shqipërisë - K.F.Granti Nr. 365

Pranojmë duke Ju falënderuar, marrjen e letrës të Shkëlqesisë Suaj, me Referencë Nr. 2661 Prot, datë 9 shkurt 2021, me anë të së cilës është kërkuar një zgjatje e të drejtës tuaj për të kryer tërheqje nga Ndihma Teknike e lartpërmendur.

Shprehim kënaqësinë të informojmë Shkëlqësinë Tuaj se e drejta në fjalë është zgjatur deri më 31 dhjetor 2021.

Duke ju siguruar bashkëpunimin e vazhdueshëm, ju lutem pranoni përsëritjet tona më të mira.

/Nënshkrimi/

Marwan Al-Ghanem

Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Operacioneve



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E BORXHIT PUBLIK DHE BASHKËRENDIMIT
TË NDIHMËS SË HUAJ
DREJTORIA E BASHKËRENDIMIT DHE SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ
SEKTORI I SIGURIMIT TË NDIHMËS SË HUAJ DHE MARRËVESHJEVE

Nr. 2661 Prot.

Tiranë, më 8/2 2021

Lënda: Granti i Asistencës teknike për Financimin e Përgatitjes së një Studimi Fizibiliteti për Projektet e Infrastrukturës së Transportit në Zonat Bregdetare Jugore të Shqipërisë

FONDIT TË KUAJITIT PËR ZHVILLIMIN EKONOMIK ARAB
P.O. Box. 2921, Safat, Kuwait-13030

Të nderuar Zotërinj,

I referohem Marrëveshjes së Grantit për Asistencë Teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për Financimin e Përgatitjes të një Studimi Fizibiliteti për Projektet e Infrastrukturës së Transportit në Zonat Bregdetare Jugore të Shqipërisë. Me qëllim finalizimin e suksesshëm të aktiviteteve për t'u financuar nga kjo letër marrëveshje, nëpërmjet kësaj shkrese ju përcjellim kërkesën e palës shqiptare si vijon:

- shtyrjen deri më 31 dhjetor 2021, të afatit të parashikuar sipas nenit 6 të Marrëveshjes së Grantit.

Kjo letër së bashku me letrën tuaj të përgjigjes do të përbëjnë marrëveshjen ndryshuese, me shkëmbim letrash të Marrëveshjes së Grantit për Asistencë Teknike ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Fondit të Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab, për Financimin e Përgatitjes të një Studimi Fizibiliteti për Projektet e Infrastrukturës së Transportit në Zonat Bregdetare Jugore të Shqipërisë.

Ky ndryshim hyn në fuqi, pasi pala shqiptare të njoftojë Fondin e Kuvajtit për Zhvillimin Ekonomik Arab për përfundimin e procedurave të brendshme.”

Me respekt,


MINISTËR
Anila Denaj

**VENDIM****Nr. 404, datë 30.6.2021**

**PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË
RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E
RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËVE
“MIQËSIA” DHE “AZEM HAJDARI -
GJELBËRIMI”, TË NDODHURA
BRENDA KONTURIT TË ZONËS SË RE
PËR ZHVILLIM, ZONA 4, NJËSIA
ADMINISTRATIVE DURRËS,
BASHKIA DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 1 400 276 890 (një miliard e katërqind milionë e dyqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari - Gjellbërimi”, të ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, të cilat shërbejnë si rrugë lidhëse me aksin kryesor të rrugës “Azem Hajdari”.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, i transferohet fondi në masën 280 055 378 (dyqind e tetëdhjetë milionë e pesëdhjetë e pesë mijë e treqind e shtatëdhjetë e tetë) lekë pa TVSH, nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë, për financimin e rikonstruksionit të rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari - Gjellbërimi”, të ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës, të cilat

shërbejnë si rrugë lidhëse me aksin kryesor të rrugës “Azem Hajdari”.

3. Caktimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit si njësi zbatuese për rikonstruksionin e rrugëve “Miqësia” dhe “Azem Hajdari - Gjellbërimi”, të ndodhura brenda konturit të zonës së re për zhvillim, zona 4, Njësia Administrative Durrës, Bashkia Durrës.

4. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDESKRYEMINISTËR
Erion Braçe**

VENDIM**Nr. 405, datë 30.6.2021**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.
587, DATË 22.7.2020, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E
FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË
NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA
(PALLAT), TË DËMTUARA, NË ZONAT
E SHPALLURA PËR ZHVILLIM TË
DETYRUAR”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 16, pika 3, 18, pika 2, shkronja “c”, dhe 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 587, datë 22.7.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:



1. Titulli i vendimit ndryshon dhe bëhet “Për përdorimin e fondit të rindërtimit për financimin e rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall”.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 18 441 909 064 (tetëmbëdhjetë miliardë e katërqind e dyzet e një milionë e nëntëqind e nëntë mijë e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa TVSH, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, për rindërtimit të njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

3. Në pikën 2, fjalët “... në zonat e shpallura për zhvillim të detyruar ...”, zëvendësohen me “...në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall...”.

4. Pikat 2.1 dhe 3.1 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“2.1 Përdorimin e fondit, miratuar në buxhetin e vitit 2021, nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në masën 666 179 207 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

3.1 Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2021, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm”, të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 666 179 207 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e dyqind e shtatë) lekë pa TVSH, për rindërtimin e njësive të banimit në ndërtesa (pallat), të dëmtuara, në zonat e reja për zhvillim dhe rindërtim në të njëjtin truall, në bashkitë Durrës, Kavajë, Kamzë, Krujë, Kurbin, Mirditë, Lezhë, Shijak dhe Vorë.

Efekti financiar sipas kësaj pike të përballohet nga hapësira buxhetore e siguruar pas ngurtësimit në të njëjtën masë të fondeve të projekteve të rindërtimit me ecuri të ngadaltë.”.

5. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

VENDIM
Nr. 406, datë 30.6.2021

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT, PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË BANESAVE INDIVIDUALE, NDËRTIMIN DHE RIKONSTRUKSIONIN E INFRASTRUKTURËS PUBLIKE, SI DHE ÇDO NDËRHJRJE TJETËR NË FUNKSION TË RINDËRTIMIT TË KËTYRE BANESAVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nëndarja “i”, 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pikat 1 dhe 2.a, të vendimit nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 7 570 789 865 (shtatë miliardë e pesëqind e shtatëdhjetë milionë e shtatëqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale dhe ndërtimin e rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe



çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t'u kalojë njësisë zbatuese, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në masën 5 430 065 414 (pesë miliardë e katërqind e tridhjetë milionë e gjashtëdhjetë e pesë mijë e katërqind e katërmbydhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.”.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

URDHËR I PËRBASHKËT Nr. 295, datë 18.6.2021

PËR MIRATIMIN E “PROTOKOLLIT TË MASAVE ANTI-COVID-19 PËRGJATË SEZONIT TURISTIK”

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të neneve 7 dhe 9, të ligjit nr. 15/2016, “Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive”, të ndryshuar, të VKM-së nr. 171, datë 27.3.2019, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar, si dhe në zbatim të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni COVID-19,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e “Protokolli i masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Agjencia Kombëtare e Bregdetit.

3. Shfuqizohet urdhri nr. 353, datë 29.5.2020, “Për miratimin e ‘Protokollit të masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik’”.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I SHËNDETËSISË DHE
MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu

MINISTËR I TURIZMIT
DHE MJEDISIT
Blendi Klosi

PROTOKOLLI I MASAVE ANTI-COVID-19 PËRGJATË SEZONIT TURISTIK

I vlefshëm për funksionim gjatë periudhës së
pandemisë së shkaktuar nga COVID-19,
2021

Parathënie

“Protokolli i Masave anti-COVID-19”, është një dokument që rekomandohet të zbatohet nga sipërmarrja turistike, turistët/pushuesit/vizitorët për mbarëvajtjen e atyre aktiviteteve të miratuara si të lejuara, me akt normativ të Ministrisë së Shëndetësisë dhe institucioneve kompetente.

Ky Protokoll përmban parakushtet, kushtet dhe rregullat për të orientuar dhe rekomanduar industrinë turistike për masat e nevojshme që duhet të ndërmerren përgjatë periudhës së pranisë së COVID-19.

Ky Protokoll është një dokument publik, që u vihet në dispozicion të gjitha sipërmarrjeve turistike, por pa u kufizuar vetëm në to, për të garantuar mbarëvajtjen e suksesshme të aktivitetit turistik të lejuar, si dhe për parandaluar rrezikun e përhapjes së infeksionit COVID-19 gjatë zhvillimit të veprimtarisë turistike, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe vizitorëve.

Duhet të zbatohet në bashkëshoqërim dhe në zbatim të protokolleve të nxjerra nga Ministria e Shëndetësisë dhe e Mbrojtjes Sociale, është i



hapur për ndryshim në përputhje me dinamikën e situatës së infeksionit COVID-19.

1. Informacione të përgjithshme

1.1 Qëllimi

“Protokolli i masave anti-COVID-19 përgjatë sezonit turistik 2021” është një dokument mbështetës për të orientuar dhe rregulluar parakushtet e nevojshme që duhet të ndërmerren nga sipërmarrjet e shërbimeve turistike përgjatë sezonit turistik 2021, për të garantuar mbarëvajtjen e suksesshme të aktivitetit, si dhe parandaluar rrezikun e përhapjes së infeksionit COVID-19 brenda dhe jashtë sipërmarrjeve turistike, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të punonjësve dhe të vizitorëve.

Masat e propozuara në këtë Protokoll vihen në dispozicion të sipërmarrjeve e aktiviteteve turistike, në përputhje të plotë me masat e propozuara nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe nga institucione të tjera vendimmarrëse të qeverisë shqiptare.

Ky Protokoll është i vlefshëm vetëm në rast të heqjes së masave kufizuese nga qeveria shqiptare dhe në rast të lejimit të ushtrimit të aktiviteteve turistike, sipas zonave dhe territoreve të konfirmuara.

1.2 Fusha e aplikimit

Për qëllimet e këtij Protokoll, “sipërmarrje të aktiviteteve turistike” do të konsiderohet, por pa u kufizuar, çdo sipërmarrje që ofron shërbimin e akomodimit, ushqimit/pijeve, plazheve, aktiviteteve rekreative, transportit të turistëve vendës dhe/ose të huaj, udhërrëfyesve turistikë etj., përfshirë gjithë stafin e tyre me kohë të plotë dhe/ose të pjesshme.

1.3 Përditësimi periodik

Ky Protokoll miratohet në datë ____6.2021 dhe mund t’u nënshtrohet përditësimeve të ndryshme, në bazë të situatës së krijuar si pasojë e infeksionit COVID-19, si dhe kushteve apo masave të tjera në funksion të ruajtjes së shëndetit të qytetarëve të Republikës së Shqipërisë dhe vizitorëve të huaj.

1.4 Kredite

Ky dokument është përgatitur nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, duke u konsultuar gjerësisht me të gjithë grupet e interesit vendës dhe të huaj, si dhe bazuar në praktikat më të mira evropiane dhe botërore.

2. Informimi rreth masave anti-COVID-19

2.1 Informimi i masave anti-COVID-19 nga sipërmarrjet e aktiviteteve turistike

Çdo sipërmarrje turistike, që lejohet të ushtrojë aktivitetin, rekomandohet të adaptojë këtë Protokoll dhe të afishojë masat respektive në vende qartësisht të dukshme dhe pranë korridoreve të kalimit të njerëzve, mbështetur me materiale të ndryshme promovuese dhe informuese, që informojnë mbi masat që duhen ndërmarrë për parandalimin e infeksionit COVID-19.

Aty ku është e mundur të përdoren materiale promovuese të mirëkoordinuara në nivel kombëtar, duke u mbështetur në mënyrë rigoroze dhe të njësuara me udhëzimet e nxjerra për këtë qëllim nga institucionet qendrore të qeverisë shqiptare.

Materialet promovuese, afishet dhe broshurat rekomandohet të publikohen në dy gjuhë: shqip dhe anglisht ose edhe në gjuhën e vizitorëve të sipërmarrjes turistike.

Stafi menaxhues i sipërmarrjeve të aktiviteteve turistike duhet t’i promovojë dhe t’u rikujtojë këto masa stafeve të brendshme mbështetëse, si dhe vizitorëve, mbi baza periodike, në formë dhe mënyrë të qartë, madje edhe kur konsiderohet se janë bërë trajnime dhe janë marrë masat e nevojshme për parandalimin e infeksionit COVID-19.

3. Informimi rreth masave anti-COVID-19

3.1 Vlerësimi i zbatimit të masave

Rekomandohet që administratori i sipërmarrjes turistike ose një person i përcaktuar prej tij, të monitorojë procesin dhe stafin, lidhur me respektimin e masave të higjienës dhe distancës fizike, që duhen ndërmarrë për parandalimin e infeksionit COVID-19.

3.2 Trajtimi i rasteve simptomatike

Në rast se një person i pranishëm brenda strukturës akomoduese (vizitor, staf etj.) ka ethe dhe simptoma të një infeksioni respirator (kollë e thatë, dhimbje të fytyrës, vështirësi në frymëmarrje), ai duhet të njoftojë menjëherë administratorin/ose personin e caktuar prej tij, i cili njofton menjëherë Urgjencën Kombëtare 127 dhe NJVKSH-në e njësisë vendore, që i përket sipërmarrja turistike. Komunikimi duhet të bëhet mundësisht vetëm përmes telefonit.



3.3 Masat higjieno sanitare gjatë procesit të regjistrimit dhe shoqërimit të vizitorëve

- Punonjësit e recepsionit duhet të jenë të mirinformuar në lidhje me masat anti-COVID-19, në mënyrë që ata të mund të kryejnë detyrat e tyre të caktuara dhe të parandalojnë përhapjen e mundshme të infeksionit në strukturën akomoduese.

- Recepsioni duhet të ketë në dispozicion numrat e telefonit të autoriteteve shëndetësore, (Urgjencën Kombëtare dhe shërbimin epidemiologjik të NJVKSH-së përkatëse), si dhe të afishojë masat anti-COVID-19 në vend të dukshëm dhe lehtësisht të aksesueshëm për të gjithë.

- Staf i recepsionit duhet të mbajë pastër ambientin e tyre të punës dhe në fund të çdo ndërrimi turni të pastrojnë me kujdes tryezën dhe pajisjet (për shembull: telefon, tastierë, ekran me prekje, stilolapsa, lapsa etj.). Për të lehtësuar performancën dhe efektivitetin e këtij operacioni, është e përshtatshme të hiqen të gjitha sendet jothelbësore nga sipërfaqja e punës. Në recepsion duhet të ketë solucion dezinfektant me përbërje alkooli 70–85%.

- Rekomandohet që stafi të lajë duart shpesh dhe t'i dezinfektojë me xhel me përbërje alkooli 70–85%.

- Rekomandohet që nga sipërmarrja turistike të merren masa për të shmangur mbledhjet e shumë njerëzve në të njëjtin vend, si dhe për të zvogëluar në maksimum kohën e pritjes përgjatë procesit të regjistrimit. Kur është e mundur, të përdoret sistem elektronik për regjistrimin. Në strukturat akomoduese duhet të ruhet distancimi fizik deri në 2 metër.

3.4 Masa të përgjithshme të pastrimit dhe të lëvizjes

Rekomandohet pastrim i përsëritur i ambienteve.

Higjienizimi dhe larja e shpeshtë e duarve konsiderohet e domosdoshme. Pasi t'i keni larë duart me sapun dhe ujë, ju duhet t'i thani ato plotësisht. Xheli me përbërje alkoolike për higjienën e duarve duhet të përdoret në mënyrë periodike, madje edhe kur mbahen doreza.

- Maska dhe dezinfektues sipërfaqësor mund të jenë në dispozicion për vizitorët kundrejt një marrëveshjeje paraprake mes sipërmarrjes dhe pushuesve/vizitorëve.

- Struktura akomoduese duhet të vendosë në holle, korridore dhe ambiente të jashtme kosha të pajisur me qese plastike për të hedhur mbetjet e mjeteve mbrojtëse higjienike.

- Rekomandohet të fillohet me ajrosjen natyrale të dhomës duke hapur dritaret nëse ka.

- Pastrimi duhet të përfshijë të gjitha sipërfaqet, siç janë tavolinat, krevatet, karriget, telefoni, telekomanda, dorezat e dyerve dhe panelet, si dhe çdo pajisje tjetër që konsiderohet se mund të jetë e prekur nga vizitori.

- Sipërfaqet që mund të ndoten me sekrecione të frymëmarrjes ose lëngje të tjera të trupit të personit, p.sh. tualeti, basenet e larjes së duarve dhe banjat duhet të pastrohen me solucion të rregullt dezinfektues, që përmban 0.1% hipoklorit të natriumit dhe të lihen pa u shpëlarë me ujë për 10 minuta. Sipërfaqet duhen shpëlarë me ujë të pastër pas 10 minutash kontakti me klorin.

- Kur përdorimi i klorit nuk është i përshtatshëm, p.sh. pajisje telefonike, telekomandë, doreza derë, butona në ashensor etj., atëherë mund të përdoret alkooli 70%.

- Kur është e mundur, të përdoren vetëm materiale pastrimi me një përdorim.

- Të gjithë artikujt e përdorur me një përdorim (peshqir dore, doreza, maska,) duhet të vendosen në një enë me kapak dhe të hidhen sipas menaxhimit të mbeturinave të rrezikshme.

- Nëse minibari është i pranishëm dhe aktiv në dhomë, në secilin ndryshim të vizitorit rekomandohet të pastrohen të gjitha sipërfaqet e minibarit në mënyrë sistematike.

- Dyshemetë pastrohen dhe sanitarizohen me produkte të përshtatshme.

- Këshillohet të shmangni pajisjen e dhomave ose dhomave të tjera të strukturës me elemente arredimi që nuk janë objekte të pastrimit të përditshëm.

3.5 Higjiena e përgjithshme

- Dhomat duhet të mirëmbahen me standard të lartë pastërtie çdo ditë.

- Të gjitha sipërfaqet duhet të pastrohen të paktën çdo ditë me pastrues dhe ujë ose dezinfektues.

- Zonat me prekje të shpeshtë, siç janë parmakët, panelet e kontrollit të ashensorit ose dorezat e dyerve duhet të pastrohen disa herë në ditë.



- Duart duhet të lahen pas çdo veprimtarie pastrimi.

- Tualetet rekomandohen të lahen me ujë dhe dezinfektant. Ato duhet të jenë të pajisura me sapun të lëngshëm, peshqirë letre ose tharëse duarsh.

- Dezinfektoni mjedisin me dezinfektues të holluar, sipas rekomandimeve dhe standardeve të përcaktuara nga MSHMS-ja. Lëreni për 15–30 minuta para se ta shpëlani me ujë dhe ta pastroni.

Kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet zbatimit të masave të pastrimit dhe dezinfektimit në të gjitha zonat bufe, bare, restorante, kuzhina etj.) si një masë parandaluese e përgjithshme gjatë gjithë epidemisë COVID-19. Vëmendje e veçantë duhet t'u kushtohet objekteve që preken shpesh, siç janë tavolinat, karriget, enët prej porcelani, mbajtëset e kripës, piperit pecetave etj. të këtij lloji. Këto objekte duhet të pastrohen dhe të dezinfektohen përpara nisjes së orarit të vaktit të ngrënies dhe/ose sa herë që duket e nevojshme.

3.6 Ventilimi

I referohet procesit të furnizimit dhe të largimit të ajrit në ambient, i cili mund të arrihet me mjete natyrore dhe mekanike. Filtrat rekomandohen të pastrohen rregullisht dhe të zëvendësohen sipas manualeve teknike dhe udhëzimeve të prodhuesit. Dezinfektoni të gjitha sipërfaqet që konstatohen se kanë rritje të mykut si rezultat i lagështirës së tepërt. Pastroni dhe dezinfektoni të gjitha grilat mbrojtëse të sistemit të ajrimit.

3.7 Përdorimi i ashensorëve

Përdorimi i ashensorëve të evitohet kur është e mundur në të kundërt rekomandohet zbatimi i masave si në mjedise të mbyllura. Distanca mund të reduktohet për njerëzit që janë pjesë e së njëjtës familje ose që ndajnë një dhomë. Në raste të tjera, nuk rekomandohet përdorimi në të njëjtën kohë, i ashensorit nga persona që nuk janë të së njëjtës familje. Butonat e ashensorit duhet të pastrohen periodikisht. Rekomandohet mbajtja e maskës në mjediset e ashensorit.

3.8 Manuali për administrimin e ushqimit dhe të pijeve

- Kryeni larjen e duarve shpesh dhe sipas kërkesës.

- Vishni maskë dhe doreza kur përgatisni ose përdorni ushqimin.

- Shmangni pirjen e duhanit, ruani etiketën respiratore në ambientet ku përgatitet ose shërbehet ushqim.

- Ndalohet përgatitja ose prekja e ushqimeve, prekja e sipërfaqeve në kontakt me ushqimin pa pasur doreza.

- Ndalohet shijimi i ushqimit me gishta

- Ndalohet prekja e flokëve ose e pjesëve të tjera të trupit pa doreza kur ndodheni brenda zonave të përgatitjes apo të servirjes së ushqimit, pasi mund të rezultojnë në ndotje të ushqimit.

- Menaxhimi i sipërmarrjes turistike duhet të promovojë sigurinë dhe higjienën e ushqimit për personat që përgatisin dhe shpërndajnë ushqimin.

3.9 Manual për shërbimin e mishit

- Ndani mishin e papjekur nga ushqimet e tjera

- Ndani mishin e papërpunuar, shpendët, ushqimet e detit dhe vezët nga ushqime të tjera në vendet e ruajtjes së përkohshme, kontejnerë ushqimorë apo frigoriferë.

- Përdorni një dërrasë prerëse për produkte të freskëta dhe një të veçantë për mish të papjekur, shpendë dhe ushqime deti.

- Asnjëherë mos vendosni ushqim të gatuar në një pjatë që keni vendosur më parë mish të papjekur, shpendë deti, ushqime deti ose vezë.

- Mos përdorni përsëri salcat marinuese të përdorura një herë për ushqime të papërpunuara.

3.10 Higjiena e ushqimit në tërësi

Ushqimet duhet të furnizohen nga burime të sigurta dhe të transferohet në zonat e magazinimit. Furnizuesit dhe marrësit në dorëzim duhet të jenë të pajisur me maska dhe doreza.

Parandaloni ndotjen e tërthortë midis ushqimit të papërpunuar dhe atij të përgatitur për konsum, duke përdorur një trajtim të veçantë për përgatitjen dhe për ruajtje. Ushqimi, gjithashtu, duhet të mbrohet siç duhet gjatë ruajtjes dhe servirjes për të parandaluar ndotjen me pajisje, vegla dhe personel, pasi transferimi i baktereve nga një ushqim (zakonisht i papërpunuar) në një tjetër është një nga shkaqet kryesore të sëmundjeve infektive që vijnë nga ushqimi.

Ushqimi i përpunuar rekomandohet të gatuhet mirë para konsumimit.

Rekomandohet që në ambientet e gatimit, ventilimi të jetë në nivel shumë të mirë.

Në ambientet e gatimit të ketë sapun të lëngshëm, dezinfektant dhe peshqirë letre për të mundësuar larjen e shpeshtë të duarve nga personeli që punon atje.

Sigurori kontejnerë të përshtatshëm të mbeturinave të mbuluar dhe që duhen të pastrohen dy herë në ditë.


Sipërfaqet e kontaktit me ushqim të pajisjeve dhe të veglave duhet të mirëmbahen siç duhet, të mbahen të pastra dhe të higjienizohen ndërmjet përdorimeve.

Sipërfaqet e kontaktit të pajisjeve duhet të mirëmbahen të pastra.

4. Rregulla për shërbimin në bare dhe restorante

4.1 Vendorsja e tavolinave në restorante dhe bare

Tavolinat duhet të vendosen në atë mënyrë që distanca nga pjesa e pasme e një karrigeje në pjesën e pasme të një karrigeje tjetër të jetë **më shumë se 1 m larg** dhe që klientët të përballen me njëri-tjetrin nga një distancë **prej të paktën 1 m**.



Personeli që shërben ushqimin duhet të jetë i pajisur përgjatë gjithë periudhës së shërbimit me maska. Dorezat vendosen sipas nevojës kur preken ushqimet.

Në rastin e ofrimit të shërbimit bufe, administratori/menaxheri i strukturave akomoduese të kapaciteteve të mëdha (hotel/resort) rekomandohet të përcaktojë dhe të shënojë dukshëm korridorin e lëvizjes së klientëve.

Klientët rekomandohet të respektojnë distancën e rekomanduar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Në rast se përdoren makinat automatike, pijet të shërbehen vetëm në gota kartoni njëpërdorimëshe.

Pjesët e makinerive në kontakt me duart e përdoruesit rekomandohet të pastrohen dhe dezinfektohen të paktën pas çdo shërbimi dhe më shpesh nëse është e nevojshme.

4.2 Larja e enëve, lugëve, pirunëve, thikave dhe pecetave të tavolinës

Të gjitha enët, lugët, pirunët, thikat, gotat duhet të lahen dhe të dezinfektohen në një makinë larëse enësh, duke përfshirë sendet që nuk janë përdorur,

pasi ato mund të kenë qenë në kontakt me duart e klientëve ose të punonjësve.

Nëse për ndonjë arsye kërkohet larje manuale, duhet të ndiqen hapat e zakonshëm (larja, dezinfektimi, shpëlarja), duke marrë nivelin maksimal të masave paraprake. Tharja duhet të bëhet duke përdorur peshqir letre të disponueshëm.

Po kështu, mbulesat e tavolinave dhe të pecetave duhet të lahen në mënyrën e zakonshme dhe të hekurosen ose të përdoren ato me një përdorim.

4.3 Informacion dhe komunikim

Punonjësit e restoranteve dhe të bareve duhet të njihen dhe të zbatojnë me rreptësi rregullat e higjienës personale të vendosura nga MSHMS-ja. Po kështu, klientët duhet të drejtohen kur hyjnë dhe dalin nga restoranti apo bari për të dezinfektuar duart e tyre me xhel dezinfektues, që duhet vendosur në hyrje të këtyre ambienteve. Klientët duhet të ruajnë distancën e miratuar nga MSHMS-ja midis tyre.



5. Rregulla për shërbimin në plazhe

5.1 Rregulla të përgjithshme

Deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, të gjitha stacionet e plazhit, si dhe plazhet publike duhet të kenë të afishuara këshillat dhe rregullat, në kuadër të mbrojtjes nga COVID-19.

Këto rregulla konsistojnë në:

Mbani parasysh rregullat bazë për parandalimin e COVID-19:

a) lani dhe dezinfektoni duart vazhdimisht dhe në mënyrën e duhur;

b) përdorni maskat sipas udhëzimeve në fuqi të MSHMS-së;

c) grumbullimet e njerëzve duhet të trajtohen sipas udhëzimeve në fuqi të MSHMS-së;

d) mos prekni fytyrën dhe hundët me duar të palara e të padezinfektuara;

e) kur kolliteni ose teshtini mbulojeni gojën/hundën me parakrah ose me façoleta njëpërdorimëshe;

f) nëse vini re simptomat e COVID-19 telefononi nr. 127.

Në marrjen e shërbimeve në ambientet e stacionit të plazhit të respektohen kushtet dhe kriteret, sipas VKM-së 171, datë 27.3.2019, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar.

5.2 Shërbimet në stacionet e plazhit

Stafi që shërben pranë stacioneve të plazhit të ketë uniformë dalluese.

Shërbimi për pastrimin dhe mirëmbajtjen e stacionit të plazhit dhe të të gjitha ambienteve të tjera të jetë ditor.

Të kryhet dezinfektimi i krevateve të plazhit, shërbimeve higjienike dhe aksesoreve të ndryshëm çdo ditë, në mënyrë periodike; gjatë orarit të hapjes së stacionit të plazhit duhet të sigurohet vazhdimësia e pastërtisë dhe boshatisja e koshave të mbeturinave.

Të gjitha aktivitetet si (bare, *beach*-bare) duhet të jenë në përputhje me direktivat e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

5.3 Brezi i shërbimeve dhe distancat që duhen respektuar

Deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, brenda brezit të shërbimeve në stacionet e plazhit, mund të realizohen këto struktura: kioskë menaxhimi për

plazhin, kabina, shërbime higjienike, depo, pika vrojtimi/kulla e vrojtimit, hapësirë për rojën e plazhit (në rastin e plazhit publik), *beach*-bar, hapësirë për vendosjen e biçikletave.

Tavolinat në *beach*-bar duhet të kenë distance e rekomanduar nga MSHMS.

Deri në përfundim të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga infeksioni COVID-19, kushtet minimale që duhet të përmbushë një stacion plazhi në plazhet e tipit A, janë, si më poshtë vijon:

a) për çadrat dhe ndenjëset e pushuesve të respektohet distanca sipas kushteve dhe kriterëve të VKM-së 171, datë 27.3.2019, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, i ndryshuar;

b) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) duhet të jetë sipas kushteve dhe kriterëve të VKM-së 171, datë 27.3.2019, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar;

c) të ketë në dispozicion të pushuesve 1 dush me ujë të ëmbël për çdo 100 (njëqind) çadra, i cili duhet të pajiset me sapun, xhel higjienizues;

d) të gjitha kushtet e tjera, përveç sa më sipër, të përcaktuara nga Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, i ndryshuar.

Kushtet minimale që duhet të plotësojë një stacion plazhi në plazhet e tipit B, janë, si më poshtë vijon:

a) hapësira midis çadrave (nga çadra në çadër) duhet të jetë sipas kushteve dhe kriterëve të VKM-së 171, datë 27.03.2019 Për miratimin e rregullores “Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar;

b) të ketë në dispozicion të pushuesve 1 (një) dush me ujë të ëmbël për çdo 100 (njëqind) çadra, i cili duhet të pajiset me sapun, xhel higjienizues;

c) të gjitha kushtet e tjera, përveç sa më sipër, të përcaktuara nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 171, datë 27.3.2019, “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit’”, të ndryshuar.

Këndi për fëmijë

Këndet e fëmijëve do të funksionojnë sipas rregullave të distancimit fizik dhe masave higjieno sanitare, të aprovuara nga MSHMS-ja dhe ky Protokoll.

5.4 Zona e pishinës

Uji i pishinës duhet të pastrohet nga qarkullimi përmes një sistemi filtrimi të detyrueshëm.

Duhet të largohen rregullisht papastërtitë e dukshme në sipërfaqe të ujit.

E gjithë zona dhe të gjitha objektet e pishinës dhe të banjave duhet të pastrohen dhe dezinfektohen të paktën një herë në ditë, por dhe me shpesh nëse fluksi i klientëve është i lartë.

Klorinimi i ujit të bëhet rregullisht sipas standardeve dhe çdo pishinë të ketë të afishuar nivelin e klorit çdo ditë.

Shezlonget e pishinës duhet të jenë me distancë të paktën 2 metra larg nga njëri grup tek tjetri. Hoteli duhet të sigurojë materiale dezinfektuese në zonën e pishinës për të lejuar punonjësit e pishinave dhe klientët të pastrojnë shezlonget, nëse nevojitet ndërkohë shezlonget dhe mjediset e pishinave duhet të pastrohen dhe dezinfektohen çdo ditë dhe periodikisht.

Pishina të ketë kosha dhe peshqirë letre.

Punonjësi i pishinës duhet të dezinfektojë shtresat e shezlongeve dhe krahët mbështetëse.

6. SPA/Sauna, masazh dhe qendër bukurie

- Të kryhet rregullisht mbas çdo seance pastrimi i saunës përpara se të fillojë seanca tjetër.

- Të gjitha muret, dyshemetë duhet të mirëmbahen në një gjendje të pastër dhe duhet të pastrohen periodikisht.

- Sipërfaqja e shtratit të masazhit duhet të jetë prej plastike të qëndrueshme për larje ose material tjetër i papërshkueshëm nga uji, i cili është i lehtë për pastrim, dezinfektim dhe mirëmbajtje.

- Sipërfaqja e shtratit të masazhit duhet të dezinfektohet dhe më pas të shpëlahet me ujë dhe të thahet pas çdo përdorimi.

- Mbulesa letre me një përdorim duhet të hidhen në një kosh pas përdorimit.

- Nëse për klientët sigurohen veshje, ato duhet të vendosen në qese plastike të sigurta dhe t'i nënshtrohen procesit të duhur të pastrimit pas çdo përdorimi.

- Bazuar në madhësinë e ambientit, hoteli/resorti mund të lejojë një numër maksimal të klientëve në të njëjtën kohë në zonën SPA, duke respektuar distancën e aprovuar nga MSHMS-ja.

- Për klientët që dëshirojnë të shijojnë një masazh apo të përdorin sauna apo jakuzi, çdonjëri prej tyre duhet të bëjë një rezervim në mënyrë që të kontrollohet numri i tyre në respekt të distancës të aprovuar nga MSHMS-ja.

- Materialet e dezinfektimit duhet të jenë të disponueshme brenda dhe përreth zonës SPA.


7. Organizimi i konferencave MICE/ eventeve

Lejimi i konferencave, eventeve, trajnimeve, seminareve, takimeve etj., në rast të përmbushjes së kriterëve për hapësirat rekomandohet të zhvillohen:


- Zhvillimi i konferencave/eventeve, aty ku është e mundur, në sallat që mund të lejojnë distancimin fizik ose të zhvillohen në ambiente të hapura deri në 50 persona.

- Rekomandohet që ulja e pjesëmarrësve të jetë e tillë që të respektojë masat e aprovuar nga MSHMS-ja.

U-Shape with tables



U-Shape without tables



**8. Rregulla për guidat dhe ekskursionet**

Rekomandime për vizitat në muze, site kulturore, arkeologjike dhe zona të mbrojtura, për grupe të organizuara, familje apo individë:

1. Rekomandohet ruajtja e distancave fizike dhe higjienës personale, sipas udhëzimeve të MSHMS-së.

2. Në muze, site kulturore, arkeologjike dhe zona të mbrojtura vendosen kosha të posaçëm për depozitimin e mbetjeve anti-COVID.

3. Në fillim të çdo udhëtimi, guida turistike rekomandohet të japë informacionin e nevojshëm turistëve për ruajtjen e distancës fizike dhe të higjienës, sipas udhëzimeve të MSHMS-së.

URDHËR

Nr. 238, datë 27.5.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të nenit 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, të ligjit nr. 113/2020, “Për shtetësinë”, të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave, të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave zëvendësministrit të Brendshëm z. Andi Mahila të praktikave të mëposhtme:

a) Trajtimin dhe ndjekjen e procedurave për shtetasit që aplikojnë për fitimin, rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

b) Nënshkrimin e kërkesave drejtuar Shërbimit Informativ të Shtetit për shtetasit që aplikojnë për fitimin, rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

c) Nënshkrimin dhe paraqitjen e kërkesës, së bashku me dokumentacionin shoqërues drejtuar

Presidentit të Republikës, për shtetasit që aplikojnë për rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

2. Delegimin e kompetencave Drejtorit të Përgjithshëm Rregullator dhe Përputhshmërisë znj. Silvana Banushi të praktikave të mëposhtme:

a) Nënshkrimin e kërkesave drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, drejtorive vendore të policisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për shtetasit që aplikojnë për fitimin, rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

b) Kthimi i aplikimit të paraqitur në rastet e mungesës ose pasaktësisë së dokumentacionit për shtetasit që aplikojnë për fitimin, rifitimin e shtetësisë shqiptare dhe për shtetasit që kërkojnë heqjen dorë nga shtetësia shqiptare.

c) Trajtimin dhe nënshkrimin e kërkesave të ndryshme, nga persona fizikë dhe juridikë shtetas shqiptarë dhe/ose të huaj, për çështjet që lidhen me shtetësinë shqiptare.

3. Delegimin e vulës, zëvendësministrit të Brendshëm dhe drejtorit të përgjithshëm Rregullator dhe Përputhshmërisë për praktikatat e përcaktuara në pikat 1 dhe 2 të këtij urdhri.

4. Kompetencat sipas përcaktimit të pikave 1 dhe 2 të këtij urdhri do të ushtrohen nga data 18.5.2021 deri në shfuqizimin e këtij urdhri.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohet zëvendësministri i Brendshëm dhe drejtori i përgjithshëm Rregullator dhe Përputhshmërisë.

6. Me njohjen dhe zbatimin e këtij urdhri ngarkohet Drejtoria e Azilit dhe të Huajve, si dhe Shtetësisë dhe Sektori i Arkiv-Protokollit.

7. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për sigurimin e zbatimit dhe kontrollin e zbatimit të këtij urdhri.

8. Urdhri nr. 170, datë 3.3.2021, “Për delegimin e kompetencave” dhe urdhri nr. 314, datë 25.9.2020, “Për delegimin e kompetencave”, shfuqizohen.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSSHËM
Bledar Çuçi

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2021

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 96 lekë